



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10.02.2025

Nr: 73

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
DENONCIMIN NR. 4, DATË 06.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,  
TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË  
KONSOLIDUARA**

Sot më datë 10.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

**SUBJEKT:** Zj. Elisa Spiropali Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë;  
Z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

**OBJEKT:** Marrjen e hapave të nevojshëm për parandalimin e shtrirjeve të efekteve të Projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.29/2023 “Për tatim mbi të ardhurat, të ndryshuar.  
Komunikimin me Institucionin e Presidentit të Republikës për mosdekretimin dhe kthimin në Kuvendin e Shqipërisë të projektligjit të mësipërm.  
Marrjen e sanksioneve administrative bazuar në dispozitat ligjore në zbatim të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

**BAZA LIGJOR:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

**KONSTATOJ:**

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, më datë 06.02.2025, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një denoncim.

Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 4, në datën 06.02.2025.

Data: 10.02.2025

Nr: 73  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 4, datë 06.02.2025 të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”

Nga shqyrtimi paraprak i të dhënave që përmban denoncimi si dhe dokumentat bashkëlidhur tij pretendohet si vijon:

*“Në seancën plenare të datës 30 Janar 2025, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me 70 vota pro, projektligjin “Për një shtesë në ligjin 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Nga konsultimi i faqes zyrtare në internet të Presidentit të Republikës si dhe Qendrës së Botimeve Zyrtare, vërehet se ky projektligj nuk është dekretuar nga Presidenti i RSH dhe as botuar në fletoren zyrtare.*

*Projektligji parashakon që pas shkronjës “e” të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat të ndrshuar”, të shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:*

*Entitet që operojnë në struktura akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special” sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombatarisht “brand name”, të strukturuar, të cilat përfitojnë statusin special deri në dhjetor 2026.*

*Gjithashtu në raportin përkatës të Komisionit të Ekonomisë dhe Fianancat, si Komisioni përgjegjës referohet se: “Projektligji ka efekte financiare shtesë edhe në buxhetin e shtetit, por këto efekte nuk janë përcaktuar në realcion dhe ka vështirësi për t’u përlllogaritur për shkak të pamundësisë për të njohur listën përfituesëve sipas ktij ligji”.*

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

## **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Zj. Elisa Spiropali Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë;
  - Z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**